



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prodato Received/ Delivered	02.12.2021	1	viti god year
Organ / Mjeshtja Organi / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojt e Pulog Appendix	Sasia Kolicema Quantity
SKIMSHQ	5771/2021		13



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.875/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca- anëtarë si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.875/2021 të datës 21.10.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr "Ilir Konusheci " nr.133 Tophane Prishtinë, kundër organit të punësimit- Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër protokoll 5108/2021 e datës 21.10.2021, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 20.09.2021 me nr.14-112/02-0197672/21 për transfer i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Ankuesja znj. [] e punësuar në pozitën Zyrtare e lartë për planifikim dhe zhvillim, në kuadër të Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm në Komunën e Prishtinës me vendimin e datës 20.09.2021 me nr.14-112/02-0197672/21 për transfer i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Prishtinës, ankuesja transferohet përkohësisht në pozitën Zyrtare e lartë për planifikim dhe zhvillim në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit prej datës 01.10.2021 deri me datën 31.03.2022. Pas kalimit të periudhës së transferimit të përkohshëm ankuesja kthehet në pozitën e mëparshme.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin e datës 20.09.2021 me nr.14-112/02-0197672/21 për transfer i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datën 21.10.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5108/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 25.10.2021 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar tek Komuna e Prishtinës. Me datën 15.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prishtinës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës 1/8.



Administrimi i provave-Kolegji për marrjen e vendimit meritot administroj këto prova: Ankesa me numër protokoll 5108/2021 e datës 21.10.2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Vendimi i datës 20.09.2021 me nr.14-112/02-0197672/21 për transferim i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Prishtinës; Raport Mjekësor i datës 20.10.2021; Raporti ekokardiografik i datës 20.10.2021; Akt emërimi i datës 01.02.2017 me nr.112-372; Ndryshimi dhe Plotësimi i aktit të emërimit i datës 19.02.2019 me nr.112-372; Vendimi për transferim i datës 15.02.2019 me nr.14-117/01-26280/19 i nxjerrë nga Kryetari i Komunës Prishtinës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/8.

Andaj në mënyrë kronologjike Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses, është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses se transferimi përkohësisht nga pozita Zyrtare e lartë për planifikim dhe zhvillim, në kuadër Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm në pozitën Zyrtare e lartë për planifikim dhe zhvillim në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, është bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimi i ankueses është i paqëndrueshëm sepse Vendimi i datës 20.09.2021 me nr.14-112/02-0197672/21 për transferim i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Prishtinës, se transferimi përkohësisht nga pozita Zyrtare e lartë për planifikim dhe zhvillim, në kuadër Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm në pozitën Zyrtare e lartë për planifikim dhe zhvillim në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, është bërë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi për shërbimin civil, nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se "Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve" dhe dispozitave të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se "1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; dhe dispozitave të nenit 5 paragrafi 2 Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: 2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor të ankueses e cila refuzon vendimin për transferim për arsye shëndetësore dhe natyra e punës në Drejtorinë e Urbanizmit është shumë stresuese, duke bashkangjitur edhe një raport mjekësor. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se edhe ky pretendim i ankueses është i paqëndrueshëm sepse në shkresat e lëndës është edhe një raport mjekësor mirëpo në atë raport nuk specifikohet se ankuesja nuk mundet me punuar në tjetër departament për shkak të problemeve shëndetësore, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Vendimi i datës 20.09.2021 me nr.14-112/02-0197672/21 për transferim i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Prishtinës është në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Stampa e institucionit dhe data e marrjes së vendimit.

Vendimi hyn në fuqi ne ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Kolegjit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.875/2021,datë 02.12.2021

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

